



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:070023
Datë: 06.03.2024
Numri i dokumentit: 05415039

E.nr.1030/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtari Faton Ajvazi me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit A.Sh. nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson av Leutrim Ademi nga Mitrovica, kundër debitorit Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 06.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.1030/2022**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1030/2022, të datës 02.09.2022, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit C.nr.978/20, të datës 09.03.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 25.01.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës, që nga llogaria e debitorit, ta transferoj shumën e mjeteve prej 558.40 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.1030/22, më datë 06.03.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi